



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 37, datë 23 / 07 /2026

**“PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I
BLLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND NGA FONDI I KUSHTËZUAR
DHE NGA BUXHETI I BASHKISË KAVAJË, PËR MUAJIN Qershor 2026”**

Në mbështetje të Ligjit 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, I ndryshuar; Ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, I ndryshuar ; Ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”; Ligjit 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” indryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.59, dt.16.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë për vitin 2026”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresën nr.1752/2 prot, dt.24.12.2025, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.2 dt.22.01.2026 “Për miratimin e kriterëve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor”, si dhe referuar relacionit permbledhës, Drejtoria e Shërbimit Social me propozim të kryetarit të Bashkisë, i paraqet Këshillit Bashkiak, i cili mori në shqyrtim dhe:

VENDOSI

- 1.Miratimin e listës përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për ndihmën ekonomike për muajin **Qershor 2026**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr. Familjeve 5, fondi 29.360 lekë.**
- 2.Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga buxheti i Bashkisë Kavajë, për muajin **Qershor 2026**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr.familjeve 93, fondi 375.679 lekë.**
3. Efektet financiare të këtij vendimi, do të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për 6% e sistemit, dhe nga buxheti Bashkisë Kavajë, llogaria “Transferte në buxhetet familjare”.

- 4.Ngarkohen Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Shërbimit Social,Spektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK, dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.
- 5.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar



Sekretari i Këshillit Bashkiak

MERI BITURKU

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

RUDIN HYLVIU



Miratuar me vota	<u>22</u>
Vota Pro	<u>22</u>
Vota Kunder	<u>—</u>
Vota Abstenim	<u>—</u>
Zbardhur me datë	<u>24/07/2026</u>